



REPUBLIKA E KOSOVES - RIPA - REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 2-D/DPK
Nr. Prot. 01-1401/A3
Nr. Stranica 03
Datum 15-05-2013
No. pages



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	13.05.2013
REFERENC-Ë:	AKK-D.P.
PËR/ZA/TO:	z. Naser Canolli – Drejtor i Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	z. Hasan Preteni – Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion – Ofrimi i këshillimit profesional lidhur me Parandalimin e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik

I nderuar z. Canolli,

Në kuadër të kompetencave të Agjencisë kundër Korrupsionit lidhur me konfliktin e interesit, sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (L.P.K.I.), Agjencia; *"bënë këshillimin e zyrtarëve të lartë të veçantë, të eprorëve, të institucioneve eprorë, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave, dhe për çështje të etikës të lidhura me to, si dhe me regjistrimin rast për rast të interesave"*, (Neni 19, pika 1.5, e Ligjit Nr.04/L-051).

Konform kësaj pike, kur kërkohet për sqarimin e situatës konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, ju me të drejtë pyetjen tuaj e keni adresuar në institucionin, gjegjesisht organin qendror kompetent – Agjencia kundër Korrupsionit.

Lidhur me kërkesen tuaj, në pajtim me mandatin që kemi dhe duke u bazuar në Ligjet bazë të Agjencisë, për rastin e caktuar, kemi nxjerr këtë :

Faqe 1 nga 1

OPINION

Këtu do tu njoftojmë cilat situata konsiderohen konflikt interesi për zyrtarin dhe po ashtu, në bazë të kërkesës tuaj me numër protokoli të AKK-së DPKI-03-1198/13, do të përgjigjemi në pyetjen që ju e keni parashtruar në shkresën tuaj të datës 11.03.2013.

Së pari është me rëndësi të citojmë nenin 6 të Ligjit për Parandalimin e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik, i cili përkufizon *çka është konflikti i interesit ?*.

Nga ky përkufizim kuptojmë, pos të tjerash, se; *“konflikti i interesit është gjendja e mos pajtimit ndërmjet detyrës publike dhe interesit privat të zyrtarit të lartë, kur ai ka interesa private të drejtëpërdrejta ose të tërthorta, personale ose pasurore, të cilat ndikojnë, ose duket sikur ndikojnë në ligjshmërinë, transparencën, objektivitetin dhe paanësinë e tij gjatë ushtrimit të funksionit publik”*.

Te Neni 10 i Ligjit për Parandalimin e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik, janë të rregulluara situatat kur zyrtari i lartë ushtron edhe veprimtari të tjera krahas funksionit të tij publik.

Në paragrafin 1 të nenit 10 shprehimisht thuhet:

“Zyrtari i lartë i zgjedhur si përfaqësues i partisë politike ruan të drejtën e ushtrimit të funksionit në parti politike nëse me ligj të veçantë nuk është paraparë ndryshe”.

Nga ana tjetër, Ligji për parandalimin e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik në paragrafet e nenit 8 ka paraparë *“Detyrimet e zyrtarit të lartë për të parandaluar konfliktin e interesit”*.

Prandaj, në rastin tuaj konkret, përgjegjen në pyetjen tuaj e gjeni pikërisht në përkufizimin e paragrafit 1 të nenit 10 të ligjit për P.K.I., lidhur me atë se a përbën konflikt interesi ushtrimi i funksionit të Drejtorit të Zyrës së Gazetës Zyrtare, si dhe të qenurit Anëtar i Këshillit Drejtues të Partisë Politike. Por, pikërisht ky nen i ligjit nuk e përjashton kompetencën e ligjeve tjera të veçanta të cilat kanë parashikuar diçka të tillë, si në rastin tuaj që ju keni referuar Ligjit për Shërbyesit Civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil është një institucion i pavarur për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së menaxhimit në shërbimin civil dhe rregullohet me ligj të veçantë (neni 9 i Ligjit Nr. 03/L-149).

Sipas Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës shmangia nga konflikti i interesi nënkupton që *“nëpunësit civilë duhet të mos lejojnë që interesat e tyre private të bien ndesh me pozitën e tyre publike, të shmangin kryerjen e detyrave private ose publike, që bien ndesh me pozitën e tyre dhe që mund të krijojnë konflikt interesi. Nëpunësit civilë veprojnë në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe ligjit në fuqi për shmangien e konfliktit të interesit”* (Neni 5, paragrafi 1.8).

Përveq kësaj duhet të keni parasysh, patjetër, se ky Opinion, nuk e liron asnjë zyrtar të lartë nga deklarimi *“rast për rast”* i interesave private që mund të shfaqen lidhur me një vendimmarrje të caktuar.

Ky obligim për zyrtarin buron pikërisht nga baza ligjore, Neni 13 paragrafi 1 e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

“Vet deklarimi si rregull bëhet me shkrim, atëherë kur zyrtari i lartë përfshihet në një vendimmarrje për ndonjë çështje të caktuar” (Neni 13, paragrafi 3).

Me respekt,